

**STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BAJRAM KURTI-SH.P.K**

Në Këtë statut :

Ligji është Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Statuti është Statuti i Shoqërisë.

“Ditë të Plota në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

KREU i I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA, DHE ADRESA E FAQES SË INTERNETIT.

NENI 1

DATA E THEMELIMIT EMRI DHE THEMELUESIT

Sot me datë **04.05.2020**, (Katërmajdymijëenjzetë), **NE** themeluesit kemi krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin : **BAJRAM KURTI-SH.P.K**

Themeluesit e shoqërisë janë :

1 - Z.Resul KURTI, i biri e Bajramit, me shtetësi shqiptare, mbajtës i dokumentit të identitetit **nr.personal/personal no. I902130080**, banues në qytetin Peshkopi, Njësia administrative Peshkopi/Dibër

2 - Z. Alket KURTI, i biri e Bajramit, me shtetësi shqiptare, mbajtës i dokumentit të identitetit **nr.personal/personal no. J101200071**, banues në qytetin Peshkopi, Njësia administrative Peshkopi/Dibër.

NENI 2

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

a) Në fushën e tregtisë në drejtimet e mëposhtme :

- Veprimtari tregtare, përfshirë tregtimin me shumicë dhe pakicë të mallrave ushqimore dhe industriale, ndërtimore, elektrike, elektronike, bujqësore, blektorale, tekstile, hidrosanitare, makineri dhe aparatura, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

- Tregtim pajisjesh elektronike, pajisjesh elektro-shtëpiake dhe aparateve të radios e televizionit.

- Tregtim, plehrash kimike, pesticidesh, etj

- Import-Eksport mallrash të ndryshme, të makinerive industriale, të makinerive bujqësore e agregateve të tyre,

- b) Në fushën e transportit, në drejtimet e mëposhtme :

- Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda e jashtë vendit, për vete dhe për të tretë.

Në qoftë se shoqërisë për kryerjen e aktivitetit do t'i nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë mbi 15 vjet (**Pa afat**).

NENI 4

SELIA ,ADRESA E FAQES SË INTERNETIT DHE ADRESA ELEKTRONIKE

Shoqëria e ka SELINË në **Diber, qyteti Peshkopi, Lagja "Gjok Doçi", Rruga "Gjergj Kastrioti", Objekti Nr.Pasurie 2/227/ish fabrika e makaronave-Peshkopi, Z.K. Nr.2932**

Albet Kurti

Resul Kurti

Adresa e Faqes së Internetit të shoqërisë është :
Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është : **luli_kurti@live.com**

KREU i II
KAPITALI I REGJISTRUAR
NENI 5

VLERA DHE PAGESA E KAPITALIT TË REGJISTRUAR

1 – Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është : **100 000 Lek (Njëqindmijëlekë).**

Pjesëmarrja e Ortakëve Themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e formuar tërësisht nga Ortakët Themelues në masën 100% të vlerës së tij.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë përbehet nga kontributi i Ortakëve Themelues dhe përbehet nga kontributi në para në vlerën **100 000 Lek (Njëqindmijëlekë)..**

Vlera totale e kapitalit të regjistruar (Vlera e paguar) është **100 000 Lek (Njëqindmijëlekë)..**

Kontributet në Para do të paguhen plotësisht me kontributin e Ortakëve Themelues që në momentin e regjistrimit fillestar.

Pagesat e kontributeve në Para kryhen në llogarinë Nr. _____ pranë degës së “ _____ BANK” - Peshkopi.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar (Vlera e paguar) është **100 000 Lek (Njëqindmijëlekë).**

Kapitali themeltar prej **100 000 Lek (Njëqindmijëlekë) lek ndahet në 2 pjesë (kuota)**, dhe vlera nominale për secilën nga kuotat është :

Ortaku **Z.Resul KURTI**, zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1(kuotë)** pjesë, me vlerë totale prej **50 000 Lekë.(Pesëdhjetëmijë lek)**

Ortaku **Z.Aiket KURTI**, zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1(kuotë)** pjesë, me vlerë totale prej **50 000 Lekë.(Pesëdhjetëmijë lek)**

KONTRIBUTET

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët e shoqërisë si vijon :

Ortaku **Z.Resul KURTI**, zotëron **50 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1(kuotë)** pjesë, me vlerë totale prej **50 000 Lekë.(Pesëdhjetëmijë lek)**

Ortaku **Z.Aiket KURTI**, zotëron **50 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1(kuotë)** pjesë, me vlerë totale prej **50 000 Lekë.(Pesëdhjetëmijë lek).**

Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeme të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute, sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvoglimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte, që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvoglimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë, ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Albet Kurti

Rosal Kurti

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar e të drejtat që rrjedhim prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) - kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) - shitblerjes
- c) - trashëgimisë
- ç) - dhurimit
- d) - çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie

KREU i III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi **i vetëm vendimmarrës** i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse(s) për marrjen e vendimeve të shoqërisë për çështjet e mëposhtme :

- 1) - përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- 2) - emërimin e shkarkimin e administratorëve
- 3) - emërimin e shkarkimin e likuidueve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 4) - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.
- 5) - mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 6) - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 7) - zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- 8) - pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- 9) - përfaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- 10) - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11) - miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë.
- 12) - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, **jo më vonë se 7 (shtatë) ditë** përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Albert Xunti

Rosel Xunti

Kur Asambleja e Përgjithëshme nuk është thirrur sipas pikes 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithëshme mund të marrë vendime vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetepërqind) të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithëshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithëshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithëshme vendos me $\frac{3}{4}$ (tri të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithëshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) - përcaktimi i politikave tregatave të shoqërisë
- b) - emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) - emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
- ç) - përcaktimin e shpërblimeve
- d) - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) - perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- f) - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 12

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithëshme merr vendim për :

- a) - vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b) - shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
- c) - ngritjen e ndonjë padie ndaj tij nga shoqëria
- ç) - dhënien ose jo të përfitimeve të reja

2.Kur ortakë përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakë, të cilin përfaqëson.

Albet
Lenti

Reza Vendi
Ryfo

NENI 13

ADMINISTRIMI

(1).Asambleja e Përgjithëshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritjeje.Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2).Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3 – Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Resul KURTI**. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë pesëvjeçare (5) me të drejtë ripërtëritje, duke filluar afatin e qëndrimit në detyrë që me datën **04.05.2020** deri me datën **04.05.2025**

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët (Administratori) kanë (ka) të drejtë e detyrohen(t) të :

a) -Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithëshme

b) -Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare

c) -Të kujdesen (t) për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë.

ç) - Të përgatisin (së) dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin dokumentat përpara Asamblesë së Përgjithëshme për miratim.

d) - Të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

dh)-Të kryejnë (ë) regjistrimet dhe dërgojnë (jë) të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

e) - Të raportojnë para asamblesë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme më rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

ë) - Të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme në raste kur :

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda (3) muajve në vazhdim.

- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se **5% (pesëpërqind) të aseteve të shoqërisë**, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse Asambleja e Përgjithëshme emëron më shumë se një administrator, **ata** e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithëshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme (thjeshtë).

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Albert Kurti

Resul Kurti

NENI 15

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT/VE

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet :

1.a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe statut në mirëbesim dhe në interesin më mirë të shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis.

b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.

c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim.

ç) Të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundëshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë.

d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që (ai) ata apo personat e lidhur me (të) ta, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme :

a) U kthen ortakëve kontributet.

b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë.

c) U shpërndan aktivet e shoqërisë.

ç) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.

d) Jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët, individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Albert Kurti

Raul Kurti

KREU i IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me **01 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor**. Përrjashtimisht, viti **i parë financiar** fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me **31 Dhjetor**.

NENI 17

EKSPERTËT

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU i V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18

PRISHJA dhe LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- ç) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- d) Me vendim të gjykatës :

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, **duke caktuar** 1 (një) ose disa likuidatorë **dhe shënuar** në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "**Shoqëri në likuidim e sipër**".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithëshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit Nr.9901, datë 14.02.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në Republikën e Shqipërisë.

NENI 20

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Albert Tusti

Rozel Kyfi

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, “Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut është përpiluar në katër (4) kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin në gjuhën shqipe dhe është nënshkruar me vetëdije dhe vullnet të plotë prej secilit nga ne themeluesit .

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR BAJRAM KURTI-SH.P.K

Z. Alket KURTI
/ Alket Kurti /

Z. Resul KURTI
/ Resul Kurti /

Peshkopi, me 04 Maj 2020